

QAZIM SHEMAJ

BIBLIOTEKA
SHTETIT

8JH

5/2

**KUSH
MA MESOI
KENGEN**



poezi

0147

59.128

5435

QAZIM SHEMAJ

KUSH
MA MËSOI
KËNGËN

Poezi



SHTËPIA BOTUESE «NAIM FRASHËRI»

FLAKADANI

Një lis kujtoj nga fëmijnia..
Kur ndodhej hëna atje pranë,
më ngjante lisi tek avllia
sikur po ndizej flakadan.

Me krahë lisiin e pushtoja,
ta zbrisja poshtë në livadh,
të rendja fushës, malit doja
me flakadanin tim të madh.

...Atdhe, u rrita. Mosha ime
në burrërinë tënde hyri,
po imazhi i lisit të vendlindjes
s'më ndahet dot një çast nga syri

1977

• TI QË S'KE FSHIRË DJERSË BALLI

(Faqe nga historiku i fshatit tim)

— Dua nga një burrë për derë
se do ngre një çetë Balli.

— Ik, o bej, s'ta kemi ngenë,
kemi nxjerrë ca djem te mali.

— Kush po flet kështu me mua? —
lëshoi beu ca fjalë vreri.

— Po s'më dhatë atë që dua,
do t'ju grijë maliheri!

— Mos, mor bej, ç'të ka zënë halli,
do ta pjekim dhe byrekun;
ti që s'ke fshirë djersë balli,
s'di ta fshish as dyfekun.

PLAKU I TOKËS

*Bujkut të dalluar, pensionistit 130-
-vjeçar, Kalo Serianit, që punoi në
arë deri në ditët e fundit të je-
tës së tij.*

Ç'patën që u drodhën grunjat në ara,
ç'pati kau i arës që heshti në brinjë?!
Që nga arkivoli thinjat e bardha
u lënë udhëve e brazdave lamtumirë.

Kush i brodhi sa xha Kalua brinjët e ledhet,
kush hoqi kaq brazda të gjata me plor?!
Brazda sa meridianet e paralelet,
brazda gjer fu bë koka e bardhë si borë.

Kush brodhi vijës së ujit sa plaku i urtë,
çdo rrënjë misri me ujë për ta nginjur?!
Më ngjan sikur dhe brenda në tabut
i shshurijnë rrëkeza nëpër qerpikët e thinjur.

Shpesh me tokën... mbi brazda menduar
(nën shi e diell u ndrinte ylberi),
diç thosh me te: «Moj e uruar,
ç'hoqëm gjer na bëri të lirë ENVERI.

Ç'hiqnim ne të dy, moj e bardha,
na zinin frymën beu e aga-ferra,
ndaj sot s'dua të di sa vite vajta,
do hap me mijëra brazda të tjera.

Do hap me mijëra e mijëra brazda,
traktori në fushë e unë brinjare me qe,
se Partia që solli kaq ditë të bardha
zgjodhi për ty e më dha farë të re.»

*

* *

Njëqind e ca vjet brazdë më brazdë,
njëqind e ca vjet vijë më vijë
dhe mori diçka nga bukuria e forca e tokës
së lashtë

Dhe shtati i binte erë lis e dëllinjë,
dhe shtati i binte erë bukë e shëndet.
Mori diçka nga bujaria e tokës
dhe fjalën s'e thosh kurrë pa bereqet.

E donte tokën pa hesap, në çdo thërrime
dhe grurin e verdhë farëflori.

Kur ndjeu plaku se do të vdiste,
u tha fshatarëve: «Bijtë e mi!

Kokën do ta mbështes pranë kësaj toke,
më hidhni një grusht grurë brenda qivurit». ♦
Që ta vinte në gjumë e ta zgjonte
fëshfërima e përjetshme e grurit.

1975.

FLOKU I BORËS

Po zbret që nga retë
mbi bredh e ahishtë
dhe pyllin e qetë
mbulon me këmishë.

Rrugë e pa rrugë
rrëpirave shkon
dhe shtigjet e ngushta
pa mëshirë verbon.

Drejt detit, drejt detit
luginave zbret
dhe deti nën gunë
fut miken e vet.

Nën gunën thinjoshe
të dallgëve të tij
dhe duart bardhoshe
ia merr në gji.

VALLET DHE VETULLORET

Tokën ta mbronim nga rrebeshet
prita me gurë ngrinim maleve,
po si t'ia bënim rrebeshit të derteve?!
Jetën e grryenin rrebeshet e halleve.

Që jeta të mos merrte tatëpjetën,
të mos shkërmoqej nëpër tërthore,
nënat përpara erozionit të jetës
ngritën vallet e bukura vetullore.

E brenda harkut të valleve «pritë»
si në një tokë të pëlleshme mbinin:
motivet e dasmave, të dhimbjeve elegjite
dhe ringjalleshin ata që binin.

N Ë N Ë S

Të mblidhje gjithë këngët lirike
pranë djepit tim për net me radhë,
një mijë vëllime poetike
s'e nxënë dot shpirtin tënd të madh.

Tetë djepa tunde vrak e vruk,
me katër vallë qysh u ndave?!
Pa qumësht mbetur e pa bukë
dhe mbushën një lëndinë me varre.

Tetë djepa vazo jete kishe,
te katër hodhi rrënjë shëndeti;
për bukën, qumështin e këmishët
çdo ditë për ne pyeste pushteti.

Nënokë, ç'më hoqe aq halle,
holluar si ndër luftëra shpata,
po kënga rrodhi, rrjedh e madhe
prej teje te dy gjenerata.